



# Zëri i Grave Kosovare

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë


## Në këtë numër

RrGGK, MPMS dhe GIZ  
Publikojnë Raportin  
Buxhetimi për Mirëqenie  
Sociale ..... 2

14 Organizata Anëtare të  
RrGGK Përfitojnë Grante për  
Avokim ..... 3

Ambasadorja e SHBA-ve në  
Kosovë Viziton OJQ-në  
'Liria' ..... 4

Vita Jeta Ofron Testime  
Mjekësore pa Pagesë për  
Diagnostifikimin e  
Osteoporozës ..... 4

 Faqja në Facebook

 Lista e dërgesave të E-  
Lajmave

## Shkolla Verore Feministe Bashkon Vajzat nga Kosova dhe Serbia

Shkolla Verore Feministe mbledhi rreth 20 vajza nga Kosova dhe Serbia në Ohër të Maqedonisë, nga 15 deri më 21 korrik.

Shkolla Verore gjashtë ditore, në një ligjeratë të mbajtur nga Nadja Bobicic, adresoi historinë e lëvizjes feministe si në botë, respektivisht në Evropën Jug-Lindore. Ditën tjetër Ana Vilenica foli për Feminizmin dhe Nacionalizmin në një sesion emocional, gjatë të cilit pjesëmarrëset reflektuan lidhur me kryqëzimet në mes të kombit-shtetit, gjinisë dhe trupit të femrës, me theks të veçantë në dhunën seksuale të shkakuar ndaj grave gjatë luftës. Në ditën e tretë, nga Nicole Farnsworth pjesëmarrëset mësuuan për metodat e hulumtimit feminist. Një tjetër ligjeratë nga Sibel Halimi u fokusua në Feminizmin e Përditshëm dhe Gratë në Media. Punëtoritë e tyre përfshinin një shumëllojshmëri të metodave interaktive jo-formale të të nxënit, përfshirë edhe intervistimin për histori gojore.

“Më pëlqyen filmat e shkurtër për historitë e grave,” tha një pjesëmarrëse. “Por më së shumti [më pëlqyen] ushtrimet që i bëmë me njëra-tjetrën sepse është interesant të flitet për fëmijërinë, luftën dhe gjëra të tjera me dikë që nuk e ke njohur më parë.” Në fakt, feministet kishin kohë që e kishin kuptuar rëndësinë e ngritjes së vetëdijes dhe ndërtimit të të kuptuarit përtej kufijve si një bazë të rëndësishme për të krijuar një lëvizje feministe të shumëllojshme dhe të fortë. “Kjo është hera e parë që pata mundësinë të ulem dhe në fakt të kem një bisedë të gjatë me një vajzë shqiptare,” tha një tjetër pjesëmarrëse nga Serbia. Shumica e pjesëmarrëseve e konsideruan të rëndësishëm

intervistimin për historinë gojore, si një mundësi për të mësuar më tepër për politikën dhe atë se çka ka ndodhur në vendet e njëra-tjetrës, përfshirë edhe historitë që media në vendin e tyre nuk iu ka treguar. Pjesëmarrëset, poashtu në mes tjerash diskutuan edhe të drejtat njerëzore dhe të grave në veçanti, definicionin e aktivizmit në komunitet dhe aktivizmit akademik. Përveç diskutimeve më formale, vajzat kishin kohë të lirë edhe për t'u shoqëruar me njëra-tjetrën dhe për të kaluar kohë në plazhet e bukura të Ohrit. Ato organizuan sesione të yoga-s pranë lumit dhe vallëzuan salsa. Shkolla Verore Feministe iu ofroi pjesëmarrëseve mjetet, idetë dhe kontaktet e nevojshme për t'iu bashkangjitur organizatave feministe dhe për të mbrojtur të drejtat e grave në vendet e tyre. Në ditën e fundit ato reflektuan mbi atë se çka kishin mësuar gjatë shkollës verore dhe bënë plane konkrete për vazhdimin e kësaj iniciative. Organizatorët përkrahën ato në nbdarjen e përgjegjësisive për hapat e më tutjeshëm.

“Jam e befasuar nga idetë e tyre dhe gatishmërinë për t'i shëndërruar ato në vepra konkrete,” tha Mimoza Paçuku nga RrGGK, që është një dër organizatorët. “Është mbresëlënëse se sa shumë energji pozitive kanë ato dhe që janë të gatshme të punojnë në baza vullnetare nëse paraqitet nevoja. Kjo tregon që iniciativa për një shkollë të tillë është shumë e nevojshme. Jam shumë e lumtur që e mundësuam edhe pse nuk ishte e lehtë. Pres me padurim që pjesëmarrëset të vazhdojnë të zhvillojnë idetë e tyre dhe ta shëndërrojnë këtë shkollë në traditë.”

Shkolla Verore Feministe u organizua nga RrGGK, Alternative Girl's Center nga Krushevac, Serbi dhe Association Dea Dia nga Kovacica, Serbi si një iniciativë feministe paqe-ndërtuese për vajzat. Kjo iniciativë u përkrah nga Kvinna till Kvinna.



Shkolla Verore Feministe mbledhi rreth 20 vajza nga Kosova dhe Serbia në Ohër të Maqedonisë, nga 15 deri më 21 korrik.

## RrGGK, MPMS dhe GIZ Publikojnë Raportin *Buxheti për Mirëqenie Sociale*

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK), Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, zyrtarisht publikuan raportin e ri dhe inovativ të titulluar *Buxheti për mirëqenien sociale: Analizë e shpejtë gjinore për të njoftuar buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale*.

Raporti është hartuar nga RrGGK në bashkëpunim të ngushtë me MPMS dhe i përkrahur nga GIZ. Raporti përdorë një qasje të thjeshtë për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor që përfshiu analizën e regjistrave të cilat mbahen nga departamentet dhe divizionet e MPMS-së nga viti 2011 deri në vitin 2014, dhe më pas shfrytëzuan gjetjet për të identifikuar treguesit dhe aktivitetet specifike që mund të integrohen në dokumentet buxhetore për periudhën 2015-2017.

“Prezantimi i këtij raporti ka qenë shumë i duhur dhe i nevojshëm për qytetarët dhe përfaqësuesit e institucioneve sepse njerëzit mendojnë që buxheti është diçka e paprekshme. Megjithatë, ky raport e ka bërë atë të prekshëm,” tha Dea Pallaska O'Shaughnessy, pjesëmarrëse në publikim. “I ka bërë të qartë ‘numrat’ e ndarë për burrat dhe gratë.”

Raporti shfaqë disa befasi rreth shpërndarjes së pensioneve, asistencës sociale, shërbimeve sociale, shërbimeve të punësimit dhe aftësimit profesional për gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë në Kosovë, duke përfshirë:

- Linja buxhetore e asistencës sociale është pa nevojë e kufizuar. Asistenca sociale sipas indeksit të shportës minimale të ushqimit për një familje mesatare të përbërë prej katër anëtarëve, dallimi financiarë në buxhet është rreth €24,000,000.
- Në vitin 2013, pagat e burrave punonjës në MPMS përbënin 56% të buxhetit, ndërkaq pagat e grave 44% të buxhetit. Burrat kanë tendencë të mbajnë pozita më të larta se gratë brenda Ministrisë, gjë që mund të ndikojë në kualitetin e shërbimeve të ofruara për gratë dhe burrat.
- Edhe pse gratë dhe burrat regjistrohen si punëkërkuar pothuajse në shifra ekuivalente, më shumë burra (64%) siguruan vende pune, se sa gra (34%).
- Burrat përfituan 89% të pensionit bazë kontribut-pagues, ndërkaq gratë përfituan 11% në vitin 2013.
- MPMS nuk ka pasur fonde të mjaftueshme për ofrimin e shumicës së shërbimeve sociale në përputhje me kornizën ligjor.



RrGGK, MPMS dhe GIZ zyrtarisht publikuan raportin e ri dhe inovativ të titulluar Buxheti për mirëqenien sociale.

Qarkorja buxhetore egzistuese dhe amendamentet e propozuara për Ligjin për Barazi Gjinore inkurajojnë përdorimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor si pjesë e procesit buxhetor të Kosovës. Ky raport jep një shembull konkret të asaj se si mund të realizohet buxheti i përgjegjshëm gjinor brenda një ministrie.

Edhe pse raporti fokusohet në MPMS, ai mund të shërbejë si shembull i dobishëm për ministrinë tjera, komunat dhe aktorët e interesuar rreth asaj se si konkretisht mund ta bëjnë buxhetimin e përgjithshëm gjinor brenda institucioneve të tyre.

“Unë mendoj që ky diskutim sot është një shembull i mirë lidhur me atë se si analiza e të dhënave bëhet me qëllim të fillimit të një diskutimi. Nuk paraqet një përfundim të tij,” konkludoi Lukas Fischer nga GIZ. Ai inkurajoi një



Duke u bazuar në këto gjetje, raporti propozon mënyra konkrete për MPMS-në që të përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin e buxhetit të vet, të kontribuojë për barazinë gjinore dhe përmirësimin e mirëqenies sociale si prioritet qeveritar të deklaruar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.

“I përgëzoj organizatat përkatëse për raportin,” tha Dren Rexha, Zyrtar për Mbrojtje Sociale në Children's Rights & Emergency Relief Organization, UNICEF. “Paraqet një pasqyrë gjithpërfshirëse të analizës buxhetore prej perspektivës gjinore. Ndoshta në të ardhmen duhet të bëhet edhe një hulumtim lidhur me dizajnimin e skemave të caktuara prej të cilave përfitojnë burrat dhe gratë, në mënyrë që të shohim nëse ato transfere sociale janë dizajnuar në atë mënyrë që burrat dhe gratë vërtetë të përfitojnë prej tyre.”



diskutim të vazhdueshëm brenda MPMS dhe me palët tjera të interesuara, sa i përket të gjeturave dhe rekomandimeve të raportit.

## 14 Organizata Anëtare të RrGGK Përfitojnë Grante për Avokim

Me 8 korrik, 14 organizata anëtare të RrGGK kanë përfituruar grante nga Fondi i Grave të Kosovës (FGK) i RrGGK-së, mbështetur nga Austrian Development Agency (ADA), me shumë totale prej €43,922.

Ky raund inkurajoi iniciativat individuale për avokim të organizatave, si dhe iniciativat e përbashkëta në mes të dy organizatave përmes granteve të reja të RrGGK “Grant avokimi në partnership për ndryshim”. Dhjetë organizata përfituan grante për avokim individual dhe katër organizata përfituan dy grante për iniciativat “Grant avokimi në partnership për ndryshim”.

Organizatat që përfituan grante dhe iniciativat e tyre përfshijnë:



Me 8 korrik, 14 organizata anëtare të RrGGK kanë përfituruar grante nga Fondi i Grave të Kosovës (FGK) i RrGGK-së, mbështetur nga Austrian Development Agency (ADA), me shumë totale prej €43,806.

1. Iniciativën e OJQ Dora Dorës për “Zhvillimin e Politikave Gjinore në Komunën e Prizrenit” që synon të zhvillojë politika gjinore duke definuar qëllimet specifike për palët e interesit dhe buxhetin e nevojshëm për realizimin e Planit të ri Komunal të Veprimit drejt barazisë gjinore. Pastaj ata do të avokojnë për aprovimin e Planit të Veprimit në Asamblenë e Komunës së Prizrenit (€3,000).
2. Iniciativa e Shoqatës ‘Iniciativa e Grave’, e titulluar “Gratë e Sharrit synojnë të integrohen në jetën politike dhe sociale” ka për qëllim të integrojë gratë nga Sharrin në Komunën e Dragashit, për pjesëmarrje aktive në jetën sociale dhe politike, duke përmirësuar pozitën e tyre në familje dhe në sferën sociale (€3,000).
3. Organizata Ndër-Komunale e të Verbërve dhe me të Pamur të Dobësuar do të avokojë për “Implementimin e Ligjit për Personat e Verbër” në Prizren (€2,620).
4. OJQ Top Radio në Gjakovë do të mundohet të “Lirojë gratë dhe vajzat nga taksat komunale për biznese të reja” për rreth një vit, për të gjitha gratë dhe vajzat që duan të hapin biznes dhe nuk kanë përkrahje financiare (€3,000).
5. Iniciativa e Qendrës së Gruas ATO “Përfshirja e Grave (dhe Burrave) të komunitetit në avokim tek Kuvendi Komunal për të siguruar transport pa pagesë për të gjithë fëmijët lidhur me shkollimin e obligueshëm” synon që gratë dhe burrat në zonat rurale të avokojnë për transport për nxënësit që vijnë shkollimin e obligueshëm (€2,850).
6. Shoqata e Femrave të Shurdhëra në Prizren synon që “Gratë të bëhen aktive në mbrojtjen e shëndetit të tyre” dhe në rritjen e kualitetit të shërbimeve egzistuese për parandalimin e problemeve shëndetësore (€2,600).
7. Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave ka një iniciativë për “Identifikimin e rasteve të dhunës seksuale”, që synon të rrisë efikasitetin në mbrojtjen e personave që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës (€3,000).
8. OJQ Luna në Prilluzhë ka iniciativën: “Parandalimi është çelësi i shëndetit: Kontrollat e rregullta mjekësore shpëtojnë jetë.” Ato synojnë të ngrisin vetëdijen lidhur me përkujdesin parandalues shëndetësor për gratë dhe vajzat (€2,410).
9. Përmes iniciativës së tyre “Dhuna ndaj grave: Nuk është çështje familjare,” OJQ Venera do të monitorojë seancat gjyqësore lidhur me dhunën në familje, si dhe rastet gjyqësore që lidhen me trashëgiminë dhe divorcin. Ato, poashtu, do të avokojnë tek autoritetet që këto raste të trajtohen me seriozitet. Monitorimi do të bëhet në Gjykatën Themelore në Pejë (€2,467).
10. OJQ Blliri në Drenas do të punojë drejt “Përmirësimit të qasjes së grave në shërbime shëndetësore kualitative” (€2,975).
11. OJQ Dera e Hapur dhe OJQ Ruka Ruci përfituan një “Grant avokimi në partnership për ndryshim”, të titulluar: “Fuqizimi i grave të marginalizuara përmes njohurive dhe vetëdijësimit për Ligjin mbi Barazinë Gjinore, Ligji No. 2004/2.” Ato synojnë të fuqizojnë gratë e marginalizuara Shqiptare dhe Serbe përmes rritjes së njohurive dhe vetëdijësimit të tyre lidhur me Ligjin mbi Barazinë Gjinore, në mënyrë që ato të mund të avokojnë për implementimin e tij (€8,000).
12. OJQ Gruaja Hyjnore dhe Shoqata për Edukimin dhe Përkujdesjen e Familjes (SHEPF) poashtu përfituan “Grant avokimi në partnership për ndryshim”. Projekti “Vetëdijësohu për një jetë më të mirë” synon të përmirësojë shëndetin fizik dhe mendor të të rinjëve nga komunat e Gjakovës dhe Gjilanit (€8,000).

Të gjithë përfituesit e granteve, para se të nënshkruajnë kontratat, morrën pjesë në sesionin informues të mbajtur në Prishtinë me 8 korrik, ku stafi i RrGGK ju shpjegoi të gjitha dokumentet e nevojshme për zbatimin e projektit.

“Ky sesion është si një trajnim lidhur me implementimin e projektit, por edhe ngritje e kapaciteteve për organizatat anëtare të RrGGK, pasi që shpjegon saktësisht se si të veprohet edhe me donatorët e tjerë në implementim të projekteve,” tha një organizatë anëtare e RrGGK. Organizatat tjera u pajtuan që “Sesioni orientues na ndihmon që të jemi më të përgaditura edhe për projekte të tjera.”

## Ambasadorja e SHBA-ve në Kosovë Viziton OJQ-në ‘Liria’

Ambasadorja e SHBA-ve në Kosovë, [Tracey Ann Jacobson](#), me 1 korrik vizitoi [Qendrën Për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve ‘Liria’](#) Gjilan në Gjilan. Në vizitë poashtu morrën pjesë edhe Zyhdi Haziri, Kryetar i [Gjykatës Themelore](#); Elmina Mahmuti, Drejtoreshë e [Policisë Rajonale](#); dhe Labinota Demi, Drejtoreshë e [Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale](#).

Nazife Jonuzi, Drejtoreshë e OJQ “Liria”, u shpreh se dhuna në familje mbetet një ndër abuzimet më të mëdha të drejtave të njeriut në Kosovë.

“Dhuna ka ndodhur gjatë konfliktit dhe po ndodhë edhe tani, gjatë kohës së paqes,” tha ajo.

Një pjesë e diskutimit u fokusua në mekanizmat e rëndësishëm institucional dhe ligjor që ekzistojnë në letër, por që në praktikë nuk po implementohen.

“Për këtë arsye, qendra jonë vazhdon të avokojë në nivel lokal dhe qendror për krijimin e një sistemi afatgjatë për trajtimin e të gjitha aspekteve të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore. Kjo përfshinë edhe arritjen e zbatimit të ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe qëndrueshmëri afatgjate financiare,” shtoi Jonuzi.

Ambasadorja Jacobson përgëzoi zonjën Jonuzi dhe stafin e OJQ “Liria” për punën dhe përkushtimin e tyre drejt fuqizimit të grave, veçanërisht në rastet e dhunës në familje. Ambasadorja u zotua për përkrahje më të madhe lidhur me trajtimin e viktimave të dhunës në familje. Ajo tha që do të shtyj përpara procese në nivelin lokal dhe atë qendror lidhur me zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe lidhur me implementimin e [Programit të Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2011-2014](#).



Ambasadorja e SHBA-ve në Kosovë, me 1 korrik, vizitoi OJQ-në Liria

## Vita Jeta Ofron Testime Mjekësore pa Pagesë për Diagnostifikimin e Osteoporozës

Rreth 50 gra pensioniste mbushën plotë zyrën e OJQ [Vita Jeta](#), duke pritur që të kryejnë një testim mjekësor pa pagesë që përcakton se a vuajnë apo jo nga osteoporoza. Ky ishte grupi i katërt që po kryente testimet. Në total, 600 gra do të pranojnë shërbimin e ofruar nga Vita Jeta, e cila është organizatë anëtare e RrGGK-së.

Osteoporoza është një sëmundje e avancuar e eshtrave e cila karakterizohet nga rënia e masës dhe densitetit të eshtrave. Kjo gjë rrit rrezikun për frakturë. Pasi që shumica e rreth 1,000 anëtareve të organizatës janë pensioniste, ato janë shumë të rrezikuara nga kjo sëmundje.

“Kjo është hera e dytë që jemi përkrahur nga [Fondi i Grave të Kosovës \(FGK\)](#) i RrGGK-së lidhur me ofrimin e testeve për diagnostifikimin e rasteve potenciale të osteoporozës tek anëtarët e OJQ-së tonë; ne tashmë iu kemi ofruar këto kontrole 240 anëtareve tona gjatë vitit 2012,” tha Ajshe Nuhiu, Drejtoreshë Ekzekutive e Vita Jeta.

Shumë pak nga anëtarët e Vita Jeta mund të përballojnë kontrole të rregullta mjekësore që do t’iu mundësonte atyre detektimin e hershëm të osteoporozës. Duke e pasur parasysh këtë gjë, Shoqata poashtu ofron trajtimin dhe medikamentet për gratë që përmes këtij testimi diagnostifikohen me sëmundjen në fjalë.

“Në vitin 2012 u diagnostifikova me osteoporozë dhe mjekja së bashku me stafin e OJQ-së më ndihmuan duke më ofruar trajtim dhe medikamente,” tha Arzie Borovci, anëtare e organizatës. “Tani që e përsërita testin mjekësor, doli që gjendja ime është përmirësuar dhe unë jam në gjendje shumë më të mirë, prandaj jam shumë mirënjohëse për Vita Jeta.”



Vita Jeta ofron testime mjekësore pa pagesë për diagnostifikimin e osteoporozës, përmes iniciativës së tyre të përkrahur nga Fondi i Grave të Kosovës

Shoqata poashtu ka filluar edhe mbledhjen e nënshkrimeve për peticionin që kërkon nga Ministria e Shëndetësisë që të sigurojë për institucionin publik shëndetësor një paisje që kryen këtë ekzaminim. Kjo do t'iu mundësonte një numri më të madh të grave që të kryejnë teste mjekësore pa pagesë për diagnostifikimin e rasteve potenciale të osteoporozës.

“Ne presim që të gjitha anëtarët e OJQ-së tonë të nënshkruajnë peticionin, por nëse ky numër nuk mjafton ne nuk do të ndalemi dhe do të mbledhim edhe më shumë nënshkrime me qëllim që të arrijmë këtë qëllim,” tha Ajshe Nuhiu. Vita Jeta është mbështetur në raundin e 5-të të Fondit të Grave të Kosovës, financuar nga [Kvinna till Kvinna \(KtK\)](#).

